



ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Shkurt 2025

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE TAKON KOMANDANTIN E PËRGJITHSHËM TË GUARDIA DI FINANZA



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli, me ftesë të Ambasadës Italiane në Tiranë, mori pjesë në ceremoninë e dhurimit të dy mjeteve lundruese nga Guardia di Finanza italiane për Policinë Kufitare Shqiptare.

Gjatë kësaj ceremonie, ku të pranishëm ishin dhe ministri i Mbrojtjes, Piro Vengu e drejtues të lartë të Policisë së Shtetit, asaj Kufitare dhe Guardia di Finanza, Drejtori Gazheli takoi Komandantin e Përgjithshëm të Guardia di Finanza-s, Andrea De Gennaro. Z. Gazheli falenderoi Komandantin e Përgjithshëm për asistencën shumë të vyer dhënë Administratës Doganore Shqiptare në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis ADSH, Guardia di Finanza-s dhe Agjencisë së Doganave dhe Monopoleve Italiane firmosur në Prill 2024 në Tiranë, si dhe të projektit "Adriacustom".

Komandanti De Gennaro vlerësoi stadin e lartë të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis administratave respektive. Të dy drejtuesit e lartë shprehën gatishmërinë për vijimin dhe intensifikimin e këtij bashkëpunimi me qëllimin e vetëm, për të bërë sa më të sigurt brigjet tona detare.

DREJTUES TË DOGANËS SHQIPTARE PRITEN NGA HOMOLOGË TË DOGANËS TURKE NË ANKARA

Një delegacion i nivelit të lartë nga Dogana Shqiptare, kryesuar nga drejtuesi i Departamentit Operativo Hetimor, drejtori i Antikontrabandës dhe përfaqësuesi shqiptar në SELEC, u prit në Ankara nga zëvendës-drejtori i përgjithshëm i Doganës turke, si dhe drejtuesit e departamenteve të Antikontrabandës, Antidrogës dhe Inteligjencës.

Gjatë takimit, palët diskutuan mbi strategjitë e përbashkëta për të luftuar kontrabandën dhe trafikun e paligjshëm. Ky bashkëpunim është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të rritur efektivitetin e operacioneve doganore dhe për të siguruar një shkëmbim të shpejtë dhe efikas të informacionit midis dy vendeve.



Takimi në Ankara përforcon angazhimin e të dy vendeve për të intensifikuar përpjekjet e përbashkëta në luftën kundër kontrabandës dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme. Ky takim pason disa operacione të suksesshme të përbashkëta në luftën kundër kontrabandës dhe synon forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në këtë fushë.

"ADRIACUSTOMS" - EKSPERTË TË DOGANËS SHQIPTARE VIZITË STUDIMORE NË ANCONA, ITALI

Ekspertët e Doganës Shqiptare zhvilluan në qytetin e Anconas, Itali, vizitën studimore të radhës në kuadër të projektit "Adriacustoms" bashkëfinancuar nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF). Takimi theksoi edhe një herë sinergjinë ndërmjet Doganës Shqiptare, ADM dhe Guardia di Finanza-s, si dhe administratave doganore të Kroacisë, Malit të Zi dhe Sllovenisë në përmirësimin e kontrolleve doganore në zonën e Adriatikut.



FMN VLERËSON POZITIVISHT DOGANAT: RITJE TË KONSIDERUESHME E TË ARDHURAVE

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vlerësuar me nota të larta progresin e Administratës Doganore, që për vitin 2024, siç citon dhe FMN, "solli arritje të konsiderueshme në vjeljen e të ardhurave për mallrat e akcizës".

Sipas raportit të asistencës teknike për Administratën Doganore, treguesit kryesorë përfshijnë:

- Rritje **3%** e peshës së produkteve të importuara
- Rritje **9,3%** e totalit të tatimeve të vjela
- Rritje **8,1%** e detyrimeve të akcizës
- Rritje **8,7%** e mbledhjes së TVSH-së

Gjatë këtij misioni, ekspertët e FMN punuan ngushtë me drejtuesit e Administratës Doganore Shqiptare, përfshirë Z. Genti Gazheli, Drejtor i Përgjithshëm dhe pati diskutime edhe me zyrtarë të specializuar në analizën e risqeve, kontrollin aposteriori, operacionet e drejtorisë së akcizës etj.

Ekspertët e FMN-së u shprehën mirënjohjen drejtuesve dhe punonjësve të Administratës Doganore Shqiptare për angazhimin e tyre aktiv, për shkëmbimin e njohurive dhe për pyetjet konstruktive, çka pasqyron angazhimin e tyre të fortë për përmirësimin e administrimit doganor.

Sipas raportit, DPD ka bërë hapa të mëdhenj sa i takon përmirësimin të kuadrit të administrimit të risqeve, me përditësime vjetore të profileve të riskut dhe mbikëqyrjes strategjike nga ana e Komitetit të Menaxhimit të Riskut.



➔ DREJTORI I DOGANAVE, GENTI GAZHELI, TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E DEPARTAMENTIT AMERIKAN TË ENERGJISË



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një takim të rëndësishëm me përfaqësuesit e programit Nuclear Smuggling Detection and Deterrence (NSDD), i cili është pjesë e Departamentit Amerikan të Energjisë (U.S. Department of Energy). Ky bashkëpunim synon forcimin e kapaciteteve për zbulimin e materialeve radioaktive dhe përmirësimin e sigurisë në pikat kufitare.

Bashkëpunimi Administratës Doganore Shqiptare me NSDD është një hap i rëndësishëm për të garantuar kufij më të sigurt dhe për të kontribuar në përpjekjet globale për sigurinë bërthamore. Doganat janë një nga hallkat kryesore në garantimin e sigurisë kombëtare, duke shërbyer si vijë e parë mbrojtjeje kundër çdo aktiviteti të paligjshëm që mund të çënojë vendin tonë. Një nga sfidat kryesore është parandalimi i trafikimit të materialeve radioaktive, një rrezik serioz për sigurinë publike dhe atë globale.

DOGANA DIGJITALE



Drejtorja e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës **E-Albania**.

Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit.

Vetëm gjatë muajit Shkurt 2025 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar **719 shërbime online**.

➔ PAS DATËS 1 PRILL 2025 NDRYSHOJNË PROCEDURAT E HYRJES SË MALLRAVE NË BASHKIMIN EUROPIAN

Duke filluar nga data 1 Prill 2025, transportuesit rrugorë dhe hekurudhorë do të duhet të ofrojnë të dhëna për mallrat e dërguara në, ose përmes BE-së, përpara mbërritjes së tyre, nëpërmjet një Deklarate Përmbledhëse të Hyrjes (ENS) të plotë. Ky detyrim është i vlefshëm gjithashtu edhe për transportuesit postarë dhe postat e shpejta, që transportojnë mallra duke përdorur këto mënyra transporti, si dhe për palët e tjera, si p.sh., ofruesit e logjistikës.

Kjo pasi nga 1 shtatori 2025 sistemi aktual ICS1 do të hiqet gradualisht dhe **sistemi ICS2** do të zëvendësojë **sistemin ICS1** nëpërmjet një procesi krejtësisht të ri, në përputhje me Kodin Doganor të Bashkimit Europian. Mospërmbushja në kohë e kërkesave të sistemit ICS2 mund të sjellë si pasojë ndalimin e mallrave në kufijtë e BE-së dhe moszbatimin e formaliteteve doganore nga ana e autoriteteve doganore të BE.



Më shumë informacion rreth sistemit ICS2 disponohet në faqen e internetit të Komisionit Evropian (<https://ec.europa.eu/ICS2>) duke përfshirë fletët e të dhënave që detajojnë kërkesat për të gjithë mënyrat e transportit dhe hapat që duhen ndërmarrë për t'u përgatitur për ICS2. I gjithë dokumentacioni teknik i nevojshëm mund të gjendet në faqen web CIRCABC.

➔ DGTAXUD MË 13 MARS WEBINAR ME OPERATORËT EKONOMIKË SHQIPTARË MBI SISTEMIN ICS2

DGTAXUD, në vijim të kërkesës së Administratës Doganore Shqiptare, do të organizojë më datë 13 mars ora 10:00 -12:30 një webinar ku ekspertët e KE do të bëjnë një prezantim të shkurtër online për Sistemin ICS2, ndërsa operatorët ekonomikë mund të bëjnë pyetje në lidhje me aspektet operacionale dhe teknike të ICS2. Ky prezantim është i vlefshëm për të gjithë operatorët ekonomikë dhe transportuesit e regjistruar në RSH dhe që kanë marrë një numër EORI/RIOE në një nga vendet anëtare të BE.

Për më shumë info shiko në link:

<https://dogana.gov.al/d/171/219/0/1304/njoftim-per-shtyp-mbi-ndryshimet-ne-proceduren-e-hyrjes-se-mallrave-ne-bashkimin-europian-pas-dates-1-prill-2025-publikuar-dt-07-02-2025>

Më poshtë adresa Webex ku mund të merrni pjesë në këtë prezantim:

<https://ecconf.webex.com/wbxmjs/joinservice/sites/ecconf/meeting/download/ef16751b707b40abae685fa7815c56cb?siteurl=ecconf&MTID=m69b0fb49228c3ab26db5cb515c929e76>



DOGANA SHQIPTARE MERR PJESË NË TRAJNIMIN PËR FUQIZIMIN E GRAVE NË UNIFORMË

Dogana Shqiptare i është bashkuar Aleancës së Grave në Uniformë (WiUA) nismë e Ambasadës së Britanisë së Madhe në Shqipëri, duke marrë pjesë në tre seminare frymëzuese për punonjëset e agjencive ligjzbatuese nën uniformë, organizuar nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, në bashkëpunim me WeWomen Albania. Të mbajtura në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë, në datat 3, 6 dhe 7 Shkurt 2025, këto seminare u ndoqën edhe nga koleget e Policisë së Shtetit, të Forcave të Armatosura Shqiptare dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.



Tema kryesore e tyre ishte fuqizimi i grave në uniformë drejt barazisë më të madhe në të gjithë sektorët e sigurisë në Shqipëri, duke edukuar dhe fuqizuar ato për të shkëlqyer në rolet e tyre profesionale. Administrata Doganore Shqiptare u përfaqësua nga specialiste me eksperiencë disa vjeçare, të cilat në fund të trajnimeve u pajisën edhe me certifikata në aftësi thelbësore si, "Komunikimi Efektiv", apo "Aftësitë e Prezantimit".

DOGANA SHQIPTARE MERR KRYESIMIN E NËNKOMITETIT TË CEFTA PËR DOGANAT DHE RREGULLAT E ORIGINJËS

Në kuadër të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore, CEFTA, të nënshkruar në Bukuresht më 19 Dhjetor 2006, si dhe bazuar në Vendimin 1/2025 të Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s për themelimin e organeve të CEFTA-s dhe funksionimin e tyre për kryesimin e Komiteteve dhe Nënkomiteteve, Shqipëria, si palë e kësaj marrëveshjeje, do të kryesojë Nënkomitetin për Doganat dhe Rregullat e Originjës për vitin 2025.



Gjatë një vizite studimore të CEFTA-s mbajtur në Bruksel, si dhe në formatin online, Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, nën cilësinë e kryesimit të Nënkomitetit për Doganat dhe Rregullat e originjës, prezantoi Programin e Punës para kryetarëve të të gjitha strukturave të CEFTA-s. Prioritetet e Nënkomitetit për Doganat dhe Rregullat e Originjës në mandatin e kryesimit nga Doganat Shqiptare kanë në fokus Operatorët Ekonomikë të Autorizuar, lehtësimin e tregtisë elektronike, bashkëpunimin me organet tatimore, përmirësimin e mëtejshëm të procedurave doganore, etj.